# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8343
E shtunë, 18 korrik 2026
Çmimi 0. 50 €

## DASh-i: Dialogu Strategjik me Kosovën, kur të përmbushen kushtet dhe zotimet ndaj serbëve

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# HOVENIER: KOSOVA RREZIKON TA HUMBASË BESIMIN E UASHINGTONIT NËSE NUK VEPRON

FAQE 4-5



Kosova nuk mund të ecë përpara me prioritetet e saj kryesore pa institucione të qëndrueshme, thotë ish-ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ai paralajmëron se ngërçi politik po e dëmton pozitën e Kosovës në raport me Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë. Hovenier thotë se pezullimi i Dialogut Strategjik me Uashingtonin tashmë është një pasojë konkrete për Kosovën. Sipas tij, Prishtina duhet të veprojë më shpejt në çështjet e energjisë dhe të komunitetit serb, nëse synon ta rikthejë marrëdhënien me administratën e presidentit Donald Trump

## NGA RRUGA NË GOOGLE: SI U KTHYEN VLERËSIMET ONLINE NË ARMË PROTESTE NË SHQIPËRI?

F. 5



## PROMOVOHET LIBRI 'BASHKËBISEDIM ME FADIL VATËN (1989)', QË DOKUMENTON NJË PERIUDHË KYÇE TË HISTORISË SË KOSOVËS

F. 7




## AKTUALE



### PSE SHBA-ja DO TA "ÇMONTOJË" GJYKATËN PENALE NDËRKOMBËTARE

F. 2

### GUCATI PËR SPECIALEN: NDËRKOMBËTARËT DUHET TË JENË TË VETËDIJSHËM PËR VENDIMIN E 16 SHTATORIT, KJO GJYKATË ËSHTË POLITIKE

F. 6

### HAXHIU: SEANCA KONSTITUIVE, NË FILLIM TË GUSHTIT

F. 6

## EKONOMI



### MINISTRIA E BUJQËSISË THOTË SE RAPORTI FINAL I ANALIZAVE TË QUMËSHTIT "VITA" DO TË DALË MË 27 KORRIK

F. 8

### DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRISË E KOSOVËS DISKUTON ME DOGANËN PËR SFIDAT E BIZNESEVE

F. 8

## SPORT




### GJASHTË YJET E ARGJENTINËS RREZIKOJNË PEZULLIMIN NGA FIFA PËR FINALEN E BOTËRORIT

F. 10

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# PSE SHBA DO TA "ÇMONTOJË" GJYKATËN PENALE NDËRKOMBËTARE

**Prishtinë, 17 korrik** - Në Hagë ndodhen dy gjykata të mëdha ndërkombëtare që shpesh ngatërrohen me njëra-tjetrën. Nga njëra anë është Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) e Kombeve të Bashkuara, e cila merret me mosmarrëveshjet midis shteteve dhe ndodhet në Pallatin historik të Paqes. Nga ana tjetër është Gjykata Penale Ndërkombëtare (GjPN), e cila ekziston që nga viti 2002 dhe merret me ndjekjen penale të individëve përgjegjës për krime lufte. Ajo ndodhet në një ndërtesë moderne prej xhami dhe betoni.
Ndryshe nga OKB-ja, ku marrin pjesë 193 shtete, në GjPN janë anëtare vetëm 125 vende. Mes shteteve që nuk janë anëtare gjenden ShBA-ja, Rusia dhe Kina, si edhe disa vende të Azisë dhe Afrikës Veriore.
Kur Marco Rubio kërcënoi së fundmi se do ta shkatërronte gjykatën "tullë pas tulle", ishte e qartë se ai po i referohej GjPN-së. Ministria e tij renditi masat që ShBA po shqyrton kundër gjykatës. Mes tyre janë: ndalimi i hyrjes në ShBA për punonjësit e GjPN-së; zgjerimi i sanksioneve kundër gjykatës dhe organizatave të lidhura me të; rishikimi i rreptë i marrëdhënieve me vendet që nuk e hedhin poshtë autoritetin e GjPN-së dhe njëkohësisht përfitojnë ndihmë amerikane. ShBA-ja ka ushtruar edhe më parë presion ndaj gjykatës, por toni i ri ka tërhequr vëmendjen e ekspertëve të së drejtës ndërkombëtare në mbarë botën.
Andreas Schüller, bashkëdrejtues i programit për krimet ndërkombëtare dhe përgjegjësinë juridike në Qendrën Evropiane për të Drejtat Kushtetuese dhe të Njeriut (ECCHR) në Berlin, thotë: "ShBA-ja dhe Marco Rubio po bëjnë publike diçka që ka ndodhur prej më shumë se një viti: ushtrimin e presionit diplomatik ndaj shteteve të tjera për t'i ndryshuar qëndrimet dhe në disa raste edhe sjelljen e tyre të votimit në raport me GjPN-në".
Sipas tij, fakti që tashmë flitet hapur për një "fushatë" tregon se bëhet fjalë për një strategji më të gjerë, e cila synon të përfshijë edhe shtete të tjera që nuk janë anëtare të GjPN-së.

### Një gjykatë nga e cila askush nuk duhet t'i shpëtojë drejtësisë

ShBA-ja nuk është anëtare e Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Kjo do të thotë se veprat e kryera në territorin amerikan nuk mund të gjykohen në Hagë. Megjithatë, GjPN-ja ka juridiksion edhe kur krime të rënda dyshohet se janë kryer në territorin e një shteti anëtar.
Mbi këtë bazë janë lëshuar, ndër të tjera, urdhër-arrestet kundër presidentit rus Vladimir Putin dhe kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu.
Ekzistenca e GjPN-së lidhet me mësimet e nxjerra nga historia. Proceset e Nurembergut pas Luftës së Dytë Botërore konsiderohen si zanafilla e së drejtës penale ndërkombëtare. Më vonë, tribunalet për krimet e luftës në ish-Jugosllavi dhe për gjenocidin në Ruandë gjatë




viteve 1990 forcuan kërkesën për një institucion të përhershëm ndërkombëtar.
Juristi i së drejtës ndërkombëtare, Kai Ambos nga Universiteti i Göttingenit, thekson: "Bëhet fjalë për çështjen themelore të përgjegjësisë, qoftë në Ukrainë, Iran apo Gaza. Nuk mund të ndodhë që krime kaq të rënda të kryhen dhe përgjegjësit kryesorë, veçanërisht udhëheqësit politikë, të mbeten pa u ndëshkuar".

### A duhet të përfundojnë qytetarët amerikanë në bankën e të akuzuarve?

Në një deklaratë video, Marco Rubio pretendoi se GjPN-ja kërcënon sistemin juridik amerikan: "Oficerët e kontrollit kufitar që largojnë kriminelët e dhunshëm nga vendi ynë. Ushtarët amerikanë që rrezikojnë jetën për ta mbrojtur vendin tonë. Nëse qëndrojmë pasivë, të gjithë ata do të ishin në mëshirën e gjyqtarëve të huaj mijëra kilometra larg".
Aktualisht nuk ka asnjë procedurë penale para GjPN-së kundër shtetasve amerikanë. Veprimet e agjentëve të emigracionit dhe kufirit zhvillohen kryesisht brenda ShBA-së, ku gjykata nuk ka juridiksion.
Megjithatë, situata është ndryshe për vrasjet e synuara të trafikantëve të dyshuar të drogës në Karaibe. Ish-prokurori i GjPN-së, Luis Moreno Ocampo, i cilësoi ato në nëntor si krime të mundshme kundër njerëzimit.

### Si mund të mbrohet gjykata nga ky presion?

Kai Ambos druhet se mund të shtohet i ashtuquajturi "efekt ftohës" (chilling effect), pra që prokurorët e GjPN-së mund të tregohen më të kujdesshëm ose më të butë ndaj të dyshuarve amerikanë. Ai përmend edhe fenomenin e "mbipërputhshmërisë" me sanksionet: "Kompanitë jashtë ShBA-së mund të vendosin të mos bashkëpunojnë më me gjykatën, sepse kanë frikë se kjo mund ta dëmtojë biznesin e tyre në Amerikë".
Që vitin e kaluar, Departamenti Amerikan i Shtetit vendosi një sërë sanksionesh ndaj GjPN-së dhe disa gjyqtarëve të saj. Si reagim, gjykata u përpoq të bëhej më pak e varur nga ShBA-ja dhe, për shembull, zëvendësoi disa aplikacione të Microsoft-it me një produkt gjerman me kod të hapur.

### Mbështetja nga Evropa

Andreas Schüller mendon se shtetet anëtare mund ta ndihmojnë gjykatën përmes shumë veprimeve të vogla: "Kur fuqitë e mesme dhe shtetet më të vogla bashkohen për t'i mbështetur institucionet ndërkombëtare dhe për t'i rezistuar presionit amerikan, kjo është gjëja më e rëndësishme".
Pas kërcënimeve të Rubios, Bashkimi Evropian u rreshtua menjëherë në mbështetje të GjPN-së. Edhe ministri i Jashtëm gjerman Johann Wadephul doli në mbrojtje të saj, duke deklaruar se gjykata e bën botën "më të sigurt dhe më të drejtë".
Interesant është fakti se në vitin 2022, pas pushtimit rus të Ukrainës, edhe Senati amerikan kishte mbajtur një qëndrim të ngjashëm. Në një rezolutë, GjPN-ja u vlerësua si: "një tribunal ndërkombëtar që synon ta mbrojë sundimin e ligjit", ndërsa hetimet kundër Rusisë u përshëndetën. Një nga bashkësponsorët e asaj rezolute ishte pikërisht Marco Rubio, sot sekretar i Shtetit i ShBA-së.
(David Ehl / DW)

# SHBA-ja DO T'I ASHPËRSOJË RREGULLAT E VIZAVE PËR STUDENTËT DHE GAZETARËT E HUAJ

**Uashington, 17 korrik** - Administrata Trump ka vendosur ta shkurtojë kohëzgjatjen e vizave për studentët e huaj, pjesëmarrësit në programet e shkëmbimit arsimor dhe gazetarët.
Rregullorja e re përfundimtare e Departamentit të Sigurisë Kombëtare (DHS) përcakton një periudhë fikse qëndrimi për vizat F (për studentët ndërkombëtarë), vizat J (që u lejojnë pjesëmarrësve në programet e shkëmbimit kulturor të punojnë në ShBA) dhe vizat I (për përfaqësuesit e mediave). Aktualisht këto viza janë të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e programit të studimit ose të punësimit në ShBA.
Sipas rregullave të reja, periudha e vlefshmërisë për vizat e studentëve dhe të shkëmbimit nuk do të jetë më e gjatë se katër vjet.
Viza për gazetarët - e cila aktualisht mund të zgjasë për vite me radhë - do të kufizohet në 240 ditë, ose 90 ditë në rastin e shtetasve kinezë.
Rregullorja do të hyjë në fuqi 60 ditë pas publikimit në Regjistrin Federal, nëse nuk pengohet nga procesi i shqyrtimit në Kongres.
Presidenti Donald Trump nisi një fushatë të gjerë kundër emigracionit menjëherë pasi mori detyrën në janar 2025.
Administrata e tij ka shtuar



kontrollin ndaj emigracionit të ligjshëm, duke revokuar vizat studentore dhe kartat e gjelbra (green cards) të studentëve universitarë për shkak të pikëpamjeve të tyre ideologjike dhe duke ua hequr statusin ligjor qindra mijëra emigrantëve.
Veprimi më i fundit do të krijojë pengesa të reja për studentët ndërkombëtarë, punonjësit e programeve të shkëmbimit dhe gazetarët e huaj. Sipas DHS, mbajtësit e këtyre vizave do të kenë mundësi të aplikojnë për zgjatje të afatit të qëndrimit.
Rregullorja ua ndalon studentëve të ciklit pasuniversitar t'i ndryshojnë qëllimet e tyre arsimore në çfarëdo kohe, ose të transferohen në një universitet tjetër pa autorizim.
Gjithashtu, ajo përgjysmon afatin që studentët kanë për t'u larguar nga Shtetet e Bashkuara pas përfundimit të studimeve ose trajnimit, nga 60 ditë në 30 ditë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# NGA RRUGA NË GOOGLE: SI U KTHYEN VLERËSIMET ONLINE NË ARMË PROTESTE NË SHQIPËRI?

Revolucioni i Flamingove u zhvendos edhe në Google, me thirrje për bojkotimin e bizneseve dhe mijëra vlerësime negative ndaj tyre. Në shënjestër u vunë biznese që protestuesit i konsiderojnë përfitues të afërsisë me pushtetin. Policia po heton rreth 10 mijë llogari të dyshuara për aktivitet të koordinuar, ndërsa protestuesit këmbëngulin se po ushtrojnë lirinë e shprehjes



**Prishtinë, 17 korrik** - Dhjetëra biznese të mëdha në Shqipëri u bënë objekt i një forme të pazakontë proteste. Nuk u sulmuan me gurë apo me ngjyrë, por me mijëra vlerësime negative në Google, të shoqëruara me thirrje për bojkotim në rrjetet sociale. Brenda pak ditësh profilet online të restoranteve, kompanive dhe medieve u mbushën me komente me një yll, duke ulur ndjeshëm vlerësimet e tyre publike. Për bizneset, kjo përkthehet në një goditje të drejtpërdrejtë ndaj reputacionit dhe besimit të klientëve, ndërkaq për protestuesit është një mënyrë për të ushtruar presion ndaj kompanive që, sipas tyre, kanë përfituar nga afërsia me pushtetin.

Fushata nisi në kuadër të protestave të njohura si Revolucioni i Flamingove.

Fillimisht kishte në shënjestër artistë, këngëtarë dhe figura të njohura të showbiz-it, të cilat protestuesit i akuzonin se mbështesnin pushtetin ose kishin zgjedhur të heshtnin përballë zhvillimeve politike në vend. Shpejt ajo ndryshoi drejtimin. Objektiv u bënë edhe kompani të mëdha që, sipas protestuesve, kanë përfituar nga vendimmarrjet e qeverisë ose kanë ndërtuar marrëdhënie të privilegjuara me pushtetin.

Thirrjet për bojkot u shfaqën fillimisht në platformën sociale Reddit, më pas u përhapën në Facebook, Instagram dhe platforma të tjera, ku përdoruesit u nxitën të linin vlerësime me një yll në Google Reviews për dhjetëra kompani dhe media.

Google Reviews është një nga platformat më të përdorura për vlerësimin e bizneseve dhe, për shumë kompani, reputacioni online ndikon drejtpërdrejt në besimin e klientëve. Për këtë arsye, një numër i tyre iu drejtuan autoriteteve me kallëzime.

Policia e Shtetit tha se ka identifikuar rreth 10 mijë llogari që dyshohen se janë përfshirë në këtë aktivitet të koordinuar online dhe shtoi se verifikimet janë në proces.

Kryeministri Edi Rama i bëri thirrje Prokurorisë të veprojë ndaj atyre që i cilësoi si "dhunues të pronës publike e private" dhe "shantazhues të qytetarëve".

## Nga kontratat "1 euro" te fushata në Google

Mes bizneseve që u gjendën në qendër të kësaj fushate është edhe ai i sipërmarrësit Gjergj Luca, i njohur për aktivitetin në industrinë e përpunimit të peshkut dhe për kompleksin "Rozafa Fish City" në Elbasan.

Protestuesit e vendosën atë në shënjestër, duke pretenduar se është një nga biznesmenët që ka përfituar nga afërsia me pushtetin.

Ata u referohen, mes të tjerash, vendimeve të Këshillit të Ministrave, sipas të cilave, prej vitit 2015 kompania e tij ka marrë në përdorim pesë pasuri shtetërore me tarifën simbolike prej një euroje, në kuadër të skemës shtetërore për nxitjen e investimeve dhe punësimit.

Vetë kompania thotë se kontratat janë dhënë në përputhje me këtë skemë shtetërore dhe se investimet kanë sjellë zhvillim ekonomik dhe vende pune.

Brenda një periudhe të shkurtër profilet e bizneseve të Lucës në Google Reviews u përballën me një valë komentesh negative dhe, sipas të dhënave publike në platformë, disa prej tyre ranë nga rreth 4.5 yje në rreth 2.

Luca e përshkroi fushatën si sulm ndaj punës së ndërtuar ndër vite. "Nuk dëmtohem unë, por hidhet baltë mbi njerëz që kanë punuar me sakrificë", u shpreh ai publikisht, ndërsa në reagimet në rrjetet sociale, protestuesit i quajti "fashistë".

Radio Evropa e Lirë e pyeti Lucën nëse bizneset e tij kanë pësuar dëme konkrete nga kjo fushatë, por ai nuk pranoi të japë komente shtesë, duke thënë se qëndrimi i tij mbetet ai që ka shprehur tashmë publikisht.

Për organizatorët e protestës, Luca është vetëm një nga shembujt.

Gent Progni, pjesë e grupit koordinator të "Revolucionit të Flamingove", thotë se fushata nuk synon ta godasë biznesin privat si të tillë, por kompanitë që, sipas tij, janë pasuruar falë privilegjeve të krijuara nga pushteti. "Qytetarëve u ka ardhur në majë të hundës me njerëz që, vetëm sepse janë afër me pushtetin, marrin prona me një euro për t'u pasuruar... Kushdo është i lirë të reagojë dhe ta shprehë mendimin e tij", thotë Progni.

Ai shton se fushata është frymëzuar nga nisma të ngjashme në vende të tjera, ku rrjetet sociale janë përdorur si mjet presioni ndaj kompanive ose figurave publike.

## Liri e shprehjes apo sulm i koordinuar?

Për autoritetet shqiptare nuk bëhet fjalë vetëm për komente negative në internet.

Drejtori i Policisë së Shtetit, Skënder Hitaj, tha në fund të javës së kaluar se rreth 10 mijë llogari në rrjetet sociale dyshohen se janë përfshirë në këtë aktivitet. Sipas tij, janë identifikuar raste kur e njëjta llogari ka publikuar, brenda një kohe shumë të shkurtër, vlerësime negative për biznese në qytete të ndryshme të vendit - një model që, sipas policisë, ngre dyshime për një veprimtari të koordinuar.

Hitaj tha se autoritetet po bashkëpunojnë me platformat online dhe partnerët ndërkombëtarë për të siguruar prova dhe për t'i identifikuar personat që qëndrojnë pas këtyre veprimeve. "Çdo person që do të rezultojë i përfshirë në këtë aktivitet të kundërligjshëm, pavarësisht vendndodhjes së tij, do të përballet me forcën e ligjit", deklaroi ai.

Deklaratat e policisë u kundërshtuan menjëherë nga organizatorët e protestës, të cilët i cilësuan ato si përpjekje për të frikësuar qytetarët.

Gent Progni thotë se askush nuk mund të hetohet vetëm pse ka lënë një vlerësim negativ në një platformë online. "Nuk ka asnjë bazë ligjore të hetosh apo ndalosh dikë për një 'review' negativ. Qytetarët po shprehin mendimin e tyre për bizneset. Kjo fushatë shkon edhe në të mirë të bizneseve të tjera, që ndoshta punojnë ndershmërisht dhe jo si biznesmenët e lidhur me pushtetin", thotë ai.

Debatit iu bashkua edhe opozita.

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, tha se çdo qytetar ka të drejtë të shprehë mendimin për një shërbim privat apo publik. Megjithatë, ai bëri dallim mes kritikës së sinqertë dhe përdorimit të llogarive të rreme për të publikuar vlerësime për shërbime që nuk janë marrë kurrë, duke thënë se kjo dëmton konkurrencën e ndershme.

Njëkohësisht ai e akuzoi qeverinë se po përgatit kufizimin e rrjeteve sociale.

Në anën tjetër, kryeministri Rama e cilësoi këtë formë proteste si një "skemë kriminale" dhe tha se, me ndihmën e kompanisë Google, profileve të bizneseve po u rikthehen vlerësimet që, sipas tij, janë fituar "me punë e mund".

Ai argumentoi se sulmet online nuk dëmtojnë vetëm kompanitë e prekura, por edhe imazhin e Shqipërisë si një vend i sigurt për investime dhe turizëm. "Protesta ushqen perceptimin negativ e të pavërtetë të një vendi jomiqësor ndaj mjedisit, jomikpritës për investimet e huaja dhe të pasigurt për turistët", tha Rama në një adresim për mediet këtë javë.

Radio Evropa e Lirë kontaktoi kompaninë Google për ta pyetur nëse ka vërejtur ndonjë aktivitet të pazakonshëm në Shqipëri dhe, nëse po, çfarë masash ka marrë, por nuk mori përgjigje.

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes dhe të mendimit.

Nëse provohet mashtrimi ose aktiviteti i koordinuar, atëherë çështja mund të mos trajtohet më si liri e shprehjes, por si vepër penale, në varësi të fakteve konkrete.

Vetë Kodi Penal nuk ka një nen specifik për "review bombing".

## Si është trajtuar "review bombing" në vende të tjera?

Fushatat e koordinuara me vlerësime negative në internet nuk janë një fenomen i ri. Ato njihen ndërkombëtarisht si "review bombing" dhe, vitet e fundit, janë përdorur si formë proteste, presioni politik, por edhe shantazhi ndaj bizneseve.

Një nga rastet më të njohura u regjistrua gjatë luftës mes Izraelit dhe Hamasit - grup i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe fuqi të tjera - në vitet 2023-2024.

Restorante, kafene dhe biznese të vogla në vende të ndryshme u përballën me mijëra komente me një ose pesë yje nga përdorues që, në shumë raste, nuk kishin qenë kurrë klientë të tyre.

Google ndërhyri duke hequr një pjesë të vlerësimeve, pasi i konsideroi të rreme ose rezultat të aktivitetit të pazakontë dhe të koordinuar.

Në shumicën e rasteve të ngjashme, reagimi i parë nuk ka ardhur nga policia, por nga vetë platformat online. Ato kanë hequr vlerësimet që kanë konsideruar të rreme ose të koordinuara dhe kanë pezulluar llogaritë që kanë shkelur rregullat e përdorimit.



# HOVENIER: KOSOVA RREZIKON TA HUMBASË BESIMIN E UASHINGTONIT NËSE NUK VEPRON

Kosova nuk mund të ecë përpara me prioritetet e saj kryesore pa institucione të qëndrueshme, thotë ish-ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier. Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", ai paralajmëron se ngërçi politik po e dëmton pozitën e Kosovës në raport me Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë. Hovenier thotë se pezullimi i Dialogut Strategjik me Uashingtonin tashmë është një pasojë konkrete për Kosovën. Sipas tij, Prishtina duhet të veprojë më shpejt në çështjet e energjisë dhe të komunitetit serb, nëse synon ta rikthejë marrëdhënien me administratën e presidentit Donald Trump

Prishtinë, 17 korrik - *Ambasador Hovenier, Kosova po përballet sërish me vështirësi për të krijuar institucione funksionale. Kush e mban përgjegjësinë më të madhe për ngërçin aktual?*

**Jeffrey Hovenier**: Është e vështirë për mua të them se kush mban përgjegjësinë më të madhe për ngërçin aktual. Ajo që do të theksoja është se sa i dëmshëm është ky ngërç për qytetarët e Kosovës.

Kosova nuk mund të ecë përpara me prioritetet e saj më të rëndësishme strategjike për aq kohë sa qeveriset nga një qeveri në detyrë ose përballet me kërcënimin e zgjedhjeve të reja.

Prandaj, mendoj se ka shumë përgjegjësi për situatën aktuale.

Po të isha ende ambasador i SHBA-së në Kosovë, do të bëja gjithçka për t'i inkurajuar të gjithë liderët politikë - qoftë nga Vetëvendosje, PDK, LDK, AAK apo partitë e tjera - që të gjenin një rrugëdalje, për të mirën e vendit dhe të qytetarëve. Ata duhet të krijojnë një qeveri të re, të zgjedhin presidentin dhe t'u ofrojnë Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë një bashkëbisedues të besueshëm dhe legjitim.

*Po thoni se është e nevojshme ndërhyrja ndërkombëtare?*

**Jeffrey Hovenier:** Shpresoj që jo. Kosova është një demokraci e konsoliduar. Kanë kaluar shumë vite që nga shpallja e pavarësisë, por kjo është një provë për klasën politike: a mund t'i lërë mënjanë interesat e ngushta partiake dhe të veprojë në të mirë të qytetarëve të Kosovës? Unë besoj se po.

I njoh ende mjaft mirë politikanët e Kosovës dhe besoj se janë të aftë ta bëjnë këtë. Tani është e rëndësishme që ta bëjnë.

*Si e vlerësoni refuzimin ose hezitimin e disa partive opozitare për t'u bërë pjesë e qeverisë së ardhshme? A mbajnë edhe ato përgjegjësi për krizën, apo përgjegjësia kryesore mbetet mbi fituesen e zgjedhjeve?*

**Jeffrey Hovenier:** Nuk e di nëse dua të hyj në atë se kush, sipas meje, mban përgjegjësinë më të madhe, sepse mendoj se përgjegjësia duhet të ndahet. Por, ajo që dua të theksoj sërish është se Kosova, në këtë moment, po paguan një çmim që nuk do të duhej domosdoshmërisht ta paguante.

Të gjithë qytetarët e vendit do të ishin në një pozitë më të mirë nëse politikanët do t'i linin mënjanë disa nga dallimet e tyre të brendshme dhe do të gjenin një rrugë të përbashkët përpara, në të mirë të vendit.

*E dimë se Kosova ka mbajtur tri palë zgjedhje në një vit e gjysmë. A mendoni se problemi është bërë tani strukturor, apo do të zgjidhin ndonjë gjë zgjedhjet e reja nëse ato do të mbaheshin?*

**Jeffrey Hovenier:** Është gjithmonë e vështirë të parashikosh zgjedhjet paraprakisht, por, siç e thatë edhe ju, janë mbajtur tri palë zgjedhje dhe ky proces i pamundësisë për të formuar një qeveri të qëndrueshme ose për të zgjedhur një president, vazhdon.

Kjo ndikon negativisht në aftësinë e Kosovës për të avancuar objektivat e saj strategjike, siç janë ripozicionimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara, avancimi i aspiratës për të çuar përpara procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, anëtarësimi në Këshillin e Evropës, përfaqësimi i interesave të saj në dialogun Kosovë-Serbi dhe çështje të tjera të rëndësishme, si zhvillimi i ekonomisë.

Prandaj, e vetmja gjë që mund të them është se partnerët më të rëndësishëm të Kosovës duan të shohin një bashkëbisedues të besueshëm dhe të qëndrueshëm. Tri zgjedhje brenda 18 muajsh, kërcënimi i zgjedhjeve të tjera dhe pamundësia për të formuar një qeveri nuk e ndihmojnë Kosovën në arritjen e atyre që, sipas meje, duhet të jenë prioritetet e saj më të larta për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

*Cilat mendoni se duhet të jenë prioritetet e Kosovës?*

**Jeffrey Hovenier:** Le të flasim për disa prej tyre. Nuk është sekret se marrëdhënia me administratën [e presidentit amerikan, Donald] Trump nuk është në nivelin e dëshiruar. Treguesi më i qartë për këtë është fakti se Dialogu Strategjik me Serbinë do të nisë më 17 korrik në Uashington dhe ministri i Jashtëm [i Serbisë, Marko] Gjuriq do të jetë atje për t'u takuar me zëvendëssekretarin e Shtetit, [Christopher] Landau.

Ndërkohë, nuk ka pasur asnjë lëvizje për Dialogun Strategjik mes Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës që nga pezullimi i tij në shtator të vitit të kaluar, për shkak të dallimeve lidhur me disa zgjedhje politike të bëra nga kryeministri i atëhershëm në detyrë, Albin Kurti. Kjo është diçka që, sipas meje, Kosova duhet ta adresojë.

Mendoj se Kosova dëshiron ta pozicionojë veten si një partnere e fortë e Shteteve të Bashkuara. Këtë e kam dëgjuar nga të gjithë liderët politikë dhe të gjithë e kanë deklaruar publikisht - edhe pasi unë jam larguar nga Kosova. Por, për ta bërë këtë, duhet të kesh një qeveri. Duhet të kesh politika qeveritare. Duhet të kesh komunikim dhe angazhim. Dhe besoj se të gjithë ata që janë aktualisht në qeveri, do të thoshin se po i bëjnë këto gjëra.

Megjithatë, situata është ndryshe kur ekziston kërcënimi i zgjedhjeve të tjera, kur nuk është zgjedhur ende presidenti ose kur qeveria vazhdon të jetë në detyrë.

Për të ecur përpara duhen politika qeveritare. Një element tjetër është se Qeveria amerikane - kjo administratë amerikane,

→

administrata Trump - ka qenë mjaft e qartë për dëshirën e saj që Kosova të përfshihet në nismat amerikane për energjinë në Ballkanin Perëndimor, dhe veçanërisht në disa prej kornizave të krijuara për gazin e lëngshëm natyror (LNG).
Kjo tani është bërë një çështje politike në Kosovë. E kuptoj këtë. Por, po flas si një vëzhgues i jashtëm. Nuk përfaqësoj më Qeverinë e Shteteve të Bashkuara. Nëse Qeveria e Kosovës dëshiron të ndërtojë një marrëdhënie më të ngushtë me administratën aktuale amerikane, atëherë - me shumë gjasë - është në interesin e saj të gjejë një mënyrë për t'iu përgjigjur disa prej kërkesave dhe diskutimeve që vijnë nga Uashingtoni. Dialogu Strategjik është një mënyrë për ta bërë këtë, por nuk është e vetmja. Megjithatë, edhe për të duhet të kesh një qeveri funksionale, që të mund të ketë politika për energjinë dhe të marrë vendime përfundimtare. Ky është një grup prioritetesh.
Tani le të flasim për prioritetin evropian. Besoj se të gjithë pajtohemi se e ardhmja e Kosovës është në Evropë. Të gjithë presim që një ditë Kosova të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian dhe tashmë ka ardhur koha që ky proces të ecë përpara. Por, si mund ta bësh këtë me Bashkimin Evropian, kur nuk ke një qeveri të konsoliduar dhe vazhdon të funksionosh me institucione në detyrë? Është shumë e vështirë. Si mund të hartosh politika qeveritare për t'iu përgjigjur kërkesave të BE-së, nëse nuk ke një qeveri të plotë? Si mund t'i adresosh fushat që Bashkimi Evropian i identifikon si prioritare në raportet e tij vjetore të progresit?
Këto janë prioritetet për të cilat po flas. Dhe, në fund, është dialogu Kosovë-Serbi. Për mirë apo për keq, ai nuk do të zhduket. Bashkimi Evropian e lehtëson dialogun, por ai mbetet mekanizmi për të arritur një lloj pranimi reciprok.
Shtetet e Bashkuara, nën administratën Biden dhe të gjitha administratat e mëparshme, kanë besuar se ky proces duhet të përfundojë me njohje reciproke. Por, si mund të ecet përpara në këtë proces dhe si mund të arrihet një gjendje më e mirë në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, nëse jo përmes këtij dialogu?
Përshtypja ime është se dialogu i lehtësuar nga Bashkimi Evropian ka mbetur kryesisht i ngrirë. Jo për shkak të mungesës së dëshirës nga ana e BE-së, por për shkak të veprimeve të Serbisë, ndryshimeve të qeverive dhe zgjedhjeve në Kosovë. Ka pasur shumë pak përparim dhe kjo, sërish, ndikon negativisht te qytetarët e Kosovës.
Këto janë prioritetet, por ka edhe një tjetër: rritja dhe zhvillimi ekonomik. Qoftë kur flasim për energjinë, vendet e punës apo investimet, të gjitha janë më të lehta kur ke një qeveri të konsoliduar, për të cilën njerëzit e dinë se do të qëndrojë për një kohë. Një qeveri me politika të qarta që tërheqin investime, që e bëjnë vendin tërheqës për investitorët dhe që u japin siguri atyre që duan të investojnë ose të krijojnë vende pune në Kosovë. Sepse, ata duhet të ndihen të sigurt për stabilitetin e vendit. Në fund të fundit, Kosova është një demokraci e konsoliduar.
Tani, nuk po flasim për një situatë si ajo e viteve '90. Asgjë e ngjashme me atë. Por, njerëzit e biznesit nuk e pëlqejnë pasigurinë.
Mjafton të shihni deklaratat e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe atë që ajo kërkon: parashikueshmëri, transparencë dhe mënyra për të ndihmuar në tërheqjen e investimeve dhe për ta çuar përpara rritjen ekonomike.
Prandaj, mendoj se këto janë prioritete reale për cilëndo qeveri që do të dalë nga ky proces dhe shpresoj që ajo të jetë në gjendje t'i adresojë ato sa më shpejt.

*Në një intervistë dhënë kohën e fundit keni thënë se reputacioni i Kosovës në Uashington ka pësuar një "goditje të rëndë". Me çfarë pasojash konkrete mund të përballet Kosova nëse ky reputacion nuk rikthehet së shpejti?*
**Jeffrey Hovenier:** Siç e thashë, këtë javë nis Dialogu Strategjik me Serbinë, ndërsa, aktualisht, nuk ka një dialog të tillë me Kosovën.
Kjo për mua është për keqardhje, edhe një paraqitje jo e saktë e realitetit të rajonit.
Kosova duhet të jetë në tryezë me Shtetet e Bashkuara, po aq sa edhe Serbia, dhe ne do të kishim një agjendë ndryshe me Kosovën nga ajo që do të kemi me Serbinë. Me Serbinë do të flasim për investimet ruse dhe energjinë ruse. Shpresoj se do të flasim edhe për disa elemente të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Shpresoj se do të flasim pak edhe për Kosovën dhe për kërcënimet e bëra, përfshirë ato nga një ministre së fundmi, të cilat janë krejtësisht në kundërshtim me mënyrën se si qeveritë demokratike dhe moderne të shekullit XXI duhet të flasin për fqinjët e tyre.
Me Kosovën, biseda jonë do të duhej të përqendrohej pikërisht te prioritetet. Si t'i konsolidojmë arritjet demokratike? Si ta avancojmë rritjen dhe zhvillimin ekonomik, në mënyrë që Kosova të vazhdojë të jetë burim stabiliteti në rajon? Si të punojmë së bashku?
Por, natyrisht, me administratën Trump do të kishte edhe një bisedë me karakter transaksional, që do të përfshinte LNG-në dhe çështje të tjera të energjisë.
Prandaj, fakti që kjo bisedë nuk po zhvillohet në këtë mënyrë të strukturuar përmes Dialogut Strategjik, është tashmë një pasojë për Kosovën.
Do të thosha gjithashtu se, aktualisht, keni njerëz të mirë që shërbejnë si ministra në detyrë, por është ndryshe kur keni një qeveri të plotë.
Për shembull, është më e lehtë për ministrin e Ekonomisë të jetë në kontakt me homologët e tij amerikanë kur ata e dinë se ai




person do të vazhdojë të jetë ministër edhe për disa vite. E njëjta vlen edhe për ministrin e Jashtëm dhe të tjerët.
Këto janë pasojat për të cilat po flas.
Mendoj se nuk është sekret që disa njerëz brenda administratës Trump janë ndier të sfiduar nga disa prej zgjedhjeve që ka bërë herë pas here kryeministri në detyrë, Kurti. Kjo është arsyeja pse Dialogu Strategjik u pezullua. Por, ai ka një mundësi të madhe për ta ripozicionuar këtë marrëdhënie dhe për të ecur përpara në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara.

## Dy gjëra për Kosovën

*Atëherë, bazuar në përvojën tuaj, çfarë hapash konkretë duhet të ndërmarrë Kosova që të fillojë Dialogu Strategjik? Çfarë standardesh duhet të shohë Uashingtoni?*
**Jeffrey Hovenier:** Nuk mund të flas në emër të administratës Trump dhe as nuk do të doja ta bëja këtë. Nuk jam pjesë e diskutimeve të tyre, prandaj mund vetëm të spekuloj.
Besoj se ata do të donin të shihnin, ndoshta, dy gjëra.
E para, do të donin të shihnin një përgjigje ndaj dëshirës së tyre që Kosova të përfshihet në infrastrukturën më të gjerë rajonale të energjisë, e në veçanti në projektet që lidhen me LNG-në.
Besoj se administrata Trump e ka bërë të qartë se ky është një prioritet i saj, prandaj mendoj se, nëse po përpiqesh të ndërtosh një marrëdhënie të ngushtë me Shtetet e Bashkuara, do të ishte gjë e mençur t'i përgjigjeshe pozitivisht kësaj.
Gjëja tjetër që do të thosha është se kjo nuk është vetëm një çështje e administratës Trump. Është një çështje që ka ekzistuar edhe në administratat e tjera amerikane ku kam punuar.
Mendoj se, herë pas here, kemi pasur pikëpamje të ndryshme me disa përfaqësues të Qeverisë aktuale të Kosovës, si dhe me Qeverinë Kurti në të kaluarën, lidhur me mënyrën më të mirë për t'i trajtuar çështjet shumë të ndjeshme të komuniteteve joshumicë, veçanërisht komunitetit serb në Kosovë, si dhe çështjen shumë të vështirë të garantimit që Serbia të mos ushtrojë sovranitet jashtë kufijve të saj.
Kosova është një shtet sovran dhe duhet të jetë përgjegjëse për administrimin e shtetit të saj sovran brenda kufijve të vet. Por, njëkohësisht, duhet të jetë e ndjeshme ndaj shqetësimeve të komunitetit serb në Kosovë dhe të gjejë mënyra që Serbia të ushtrojë të drejtën që i jep Plani i Ahtisaarit për ta mbështetur atë komunitet, pa e cenuar sovranitetin e Kosovës.
Këto janë çështje shumë, shumë të vështira. Janë çështje shumë, shumë të ndjeshme. Por, mendoj se aty u ndërpre Dialogu Strategjik, ose më saktë, aty u bazua vendimi që Qeveria amerikane mori vjeshtën e kaluar. Ai lidhej posaçërisht me veprimet e ndërmarra nga autoritetet e Kosovës në këto çështje të ndjeshme, pa pasur, nga këndvështrimi amerikan, konsultime të mjaftueshme ose përpjekje për të gjetur mënyra për të ecur përpara, që do të ishin më pak shqetësuese për komunitetin etnik serb.
Prandaj, mendoj se Kosovës do t'i duhet gjithashtu të gjejë mënyra për t'i treguar Uashingtonit se Qeveria e Kosovës e kupton se kjo është një çështje e rëndësishme dhe e ndjeshme; se Kosova nuk do të heqë dorë nga sovraniteti i saj, dhe as nuk duhet ta bëjë këtë, por se do të punojë me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian për të gjetur një rrugë të përbashkët përpara në trajtimin e këtyre çështjeve.
Mendoj se këto janë dy çështjet kryesore.

*A do ta humbë Kosova besimin nëse dështon të veprojë?*
**Jeffrey Hovenier:** Mendoj se po. Sërish, nuk mund të flas në emër të kësaj administrate, por nga gjithçka që shoh, ajo është mjaft transaksionale dhe hapësira e saj e vëmendjes nuk është shumë e madhe.
Prandaj, mendoj se është e rëndësishme të shfrytëzohen mundësitë që ofrohen dhe të mos shpenzohet shumë kohë duke u menduar apo reflektuar, por, përkundrazi, të përpiqesh të gjesh fusha të përbashkëta bashkëpunimi dhe përparimi.

*Folëm për projektet e LNG-së. A mendoni se Kosova është në rrezik ta humbasë këtë mundësi strategjike të energjisë me Shtetet e Bashkuara?*
**Jeffrey Hovenier:** Këtë e kam të vështirë ta them dhe nuk jam ekspert i këtyre çështjeve. Ekspertët që merren me to, shohin se administrata Trump po sjell ndryshime në infrastrukturën energjetike të Ballkanit Perëndimor. Unë vetëm do të vë në dukje se, sa kuptoj unë, të gjithë fqinjët e Kosovës tashmë janë pjesë e një mirëkuptimi me Shtetet e Bashkuara që përfshin LNG-në amerikane si një element të infrastrukturës energjetike të rajonit.
Prandaj, është e vështirë të kuptohet pse Kosova do të ishte një rast kaq i ndryshëm, saqë kjo të mos kishte kuptim për të, nëse ka kuptim për Greqinë, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Kroacinë dhe vendet e tjera të rajonit.
Sërish, nuk kam ekspertizë në këtë fushë, por po shoh edhe sinjalet politike, dhe ato janë gjithashtu shumë të qarta nga Uashingtoni.

*Mund të jetë e vështirë të thuhet, por pse heziton Kurti, sipas jush?*
**Jeffrey Hovenier:** Kam shumë respekt për kryeministrin Kurti. Megjithatë, gjatë viteve që kam punuar me të, kam mësuar të mos përpiqem kurrë t'i shpjegoj vendimet që ai merr, sepse ai mendon në mënyrën e vet, shumë unike dhe shumë të thellë. Prandaj, mendoj se kjo pyetje do të ishte më mirë t'i bëhej atij.
Këshilla ime për të, po të isha ende atje, do të ishte: përfundoje procesin tënd të të menduarit dhe kthehu me ide, sepse vëmendja e Uashingtonit nuk është e pafundme dhe ata po presin një përgjigje pozitive.
Mendoj se do të ishte në interesin tuaj të gjeni një mënyrë për të bashkëpunuar me Shtetet e Bashkuara në këtë çështje, të paktën me administratën Trump.

## Gucati për Specialen: Ndërkombëtarët duhet të jenë të vetëdijshëm për vendimin e 16 shtatorit, kjo gjykatë është politike

**Prishtinë, 17 korrik** - Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se sot, pas dy muajsh, Gjykata Speciale në Hagë, e cila prej gati gjashtë vjetësh po u shërben interesave të Serbisë, do të vendosë nëse do ta kriminalizojë luftën e popullit tonë, ndërhyrjen e NATO-s dhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës. "Kjo gjykatë njëetnike po vendos për fatin e shtetit tonë shumetnik dhe, me vendimin e saj, mund t'i rrënojë edhe themelet e shumetnicitetit mbi të cilin është ndërtuar Kosova", ka shkruar ai në "Facebook".

Gucati ka shkruar se atje po gjykohen ata që organizuan rezistencën tonë. "Po gjykohen ata që, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë, sollën intervenimin e NATO-s dhe koordinuan bombardimin e caqeve serbe. Po gjykohen ata që e shpallën Kosovën shtet të pavarur, shumetnik dhe demokratik. Kjo gjykatë është politike. Edhe vendimi i saj do të jetë politik. Bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë e vetëdijshme për pasojat e këtij vendimi. Më 16 shtator, veteranët e UÇK-së, së bashku me çdo shqiptar, do ta presin këtë vendim të bashkuar, në Hagë dhe në çdo qytet të Kosovës", ka theksuar Gucati.



# HAXHIU: SEANCA KONSTITUIVE, NË FILLIM TË GUSHTIT

**Prishtinë, 17 korrik** - Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se seanca për konstituimin e përbërjes së re parlamentare të Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e 7 qershorit, do të mbahet në fillim të gushtit.

Në një prononcim për gazetarë, Haxhiu u shpreh se për shkak që pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës nis afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit, ka vlerësuar që t'u japë kohë partive për diskutime për çështjen e presidentit.

Pikërisht, mosarritja e konsensusit muaj më parë mes partive për një president të ri të vendit nxiti mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare.

"Afati kushtetues është deri më 7 gusht dhe në fillim të gushtit do të ketë seancë konstituive. Javën e ardhshme ju premtoj që do ta dini ditën e saktë edhe orën e saktë", tha Haxhiu për gazetarët.



Më 10 korrik, dy ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve parlamentare, udhëheqësi i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, zhvilloi takime me krerët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ndërkaq, Aleanca refuzoi ftesën e kryeministrit në detyrë, Kurti.

Kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, pas takimit me Kurtin tha se partia e tij do të mbetej në opozitë.

Ndërkaq, kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, paralajmëroi vazhdimin e diskutimeve.

Megjithatë, më 15 korrik Abdixhiku tha se është i detyruar t'i pezullojë diskutimet për formimin e institucioneve të reja me Kurtin për shkak të një nisme partiake për shkarkimin e tij nga kreu i LDK-së.

Abdixhiku paralajmëroi se vendi rrezikon që potencialisht të mbesë pa institucione dhe të ketë zgjedhje të reja në vjeshtë.

Haxhiu e vlerësoi si serioze përpjekjen e Kurtit për formimin e institucioneve të reja, e cila, sipas saj, po vazhdon.

"Kryeministri Kurti ka ftuar partitë politike për këtë qëllim, por LDK-ja i ka pezulluar negociatat, ndërsa PDK-ja ka pasur qëndrimin e vet dhe Aleanca nuk i është përgjigjur pozitivisht ftesës. Nuk mund të ketë detyrime për t'iu përgjigjur këtyre takimeve, por është shumë e rëndësishme që për hir të qytetarëve të Kosovës dhe për vetë shtetin tonë, të ketë përpjekje maksimale që ta gjejmë një zgjidhje. Askush nuk i do zgjedhjet e jashtëzakonshme në Kosovë sepse nuk do të zgjidhnin asgjë", tha Haxhiu.

Votimet e 7 qershorit ishin të tretat parlamentare që Kosova organizoi në më pak se një vit e gjysmë.

Partia në pushtet, LV-ja e Kurtit, sipas rezultatit të certifikuar, i ka fituar 53 mandate. PDK i ka fituar 22 ulëse, LDK 18 ulëse dhe Aleanca shtatë ulëse.

Për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e qeverisë nevojiten 61 vota në Kuvendin prej 120 ulësesh.

Partia e Kurtit, së bashku me partitë nga komunitetet pakicë joserbe, i kanë numrat e nevojshme për këto dy procese. Por, për presidentin nevojitet një marrëveshje politike, pasi kërkohet prania e 80 deputetëve në dy raundet e para të votimit.

Me një marrëveshje të mundshme me LDK-në, e cila i ka 18 deputetë, atëherë do të arriheshin të paktën 81 vota, mjaftueshëm për votimin e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndronin në sallë.

Nëse presidenti nuk zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e konstituimit të Kuvendit, atëherë organi ligjvënës shpërndahet dhe vendi shkon në zgjedhje të reja.

Nëse vendi shkon në zgjedhje sërish, atëherë ato do të ishin zgjedhjet e katërta parlamentare që nga fillimi i vitit 2025.

# FORUMI 'BASHKË NË SHKENCË', NJË SHTËPI E DYTË E DIASPORËS AKADEMIKE NË UP

**Prishtinë, 17 korrik** - Në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", i organizuar në kuadër të Universitetit Veror Ndërkombëtar PISU 2026, nisi edicioni i dytë i Forumit "Bashkë në Shkencë", një platformë diskutimi e bashkëpunimi mes Universitetit të Prishtinës dhe diasporës akademike.

Forumi i organizuar nga Qendra për Studime të Avancuara e Universitetit të Prishtinës, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe organizatës gjermane GIZ, nën drejtimin e profesorit Gentrit Berisha, nisi me vlerësime të larta për kontributin e personaliteteve të Kosovës që punojnë nëpër institucionet më të njohura globale të arsimit të lartë.

Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, profesorëve të pranishëm nga diaspora akademike u tha se në UP nuk janë mysafirë, por në shtëpinë e tyre. Ai tregoi se tashmë në bazë të Rregullores për transferim, programin "Brain Gain" dhe rastet e nevojës së jashtëzakonshme të rekrutimit të personelit akademik, numri i të afiliuarve në UP nga diaspora i është afruar dhjetëshit. Rektori Hajrullahu bëri thirrje që Kosova dhe UP-ja ta shfrytëzojnë potencialin e jashtëzakonshëm të dijes akademike të kosovarëve të shpërndarë nëpër botë.

Drejtori i Departamentit të Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Elis Badalli, tha se shqiptarët që jetojnë jashtë vendit janë asetet më të çmuara të Kosovës.

Krenare Loxha, nga organizata gjermane GIZ, e cilësoi Universitetin e Prishtinës një institucion të shenjtë që, përveç që prodhon dije, ka kontribuuar shumë edhe për lirinë e Kosovës.

Ajo më pas paraqiti një projekt të GIZ-it në lidhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të



Qendrës për Studime të Avancuara të UP-së, që konsiderohet shtëpia e diasporës akademike në UP, derisa profesori Gentrit Berisha foli për gjetjet dhe rekomandimet e realizuara nga edicioni i parë i Forumit "Bashkë në Shkencë".

Pastaj profesorët e UP-së, Fetah Podvorica e Kreshnik Hoti, në kumtesat e tyre folën rreth përvojave të fituara në universitetet jashtë vendit dhe vendimin për t'u kthyer në universitetin e vendlindjes.

Forumi "Bashkë në Shkencë" vazhdoi me një tryezë dhe dy panele diskutimi ku u fol për perspektivën dhe strategjitë e bashkëpunimit mes UP-së dhe diasporës akademike të Kosovës dhe rolin e studentëve shqiptarë në botë për promovimin e Universitetit të Prishtinës dhe shtetit të Kosovës.

Edicioni i parë i Forumit "Bashkë në Shkencë" u zhvillua nëntor të vitit 2025.

## Inaugurohen shkronjat e arta të UÇK-së në Retijë

**Rahovec, 17 korrik** - Në fshatin Retijë u mbajt ceremonia e inaugurimit të shkronjave të arta të UÇK-së, në praninë e familjeve të dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të luftës, përfaqësuesve institucionalë, banorëve dhe mysafirëve të shumtë. Ky aktivitet u organizua në nderim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të sakrificës së dëshmorëve, heronjve dhe të gjithë luftëtarëve që kontribuuan në çlirimin e vendit.

Retija gjatë luftës çlirimtare ishte një pikë e rëndësishme strategjike e Zonës Operative të Pashtrikut. Në këtë lokalitet u organizuan dhe u riorganizuan Brigadat 124, 125 dhe 126, të cilat dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën për liri.

Në kuadër të ceremonisë u nda dekorata komunale "Medalja e Lirisë" për disa veteranë të kësaj zone, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për kontributin e tyre të çmuar në luftën çlirimtare.

Inaugurimi i shkronjave të arta të UÇK-së dhe ndarja e dekoratave për veteranët përbëjnë një akt institucional të kujtesës dhe respektit për të gjithë ata që sakrifikuan për lirinë e Kosovës. Ky simbol do të mbetet dëshmi e




përhershme e historisë sonë, e vlerave të luftës çlirimtare dhe e përkushtimit për t'i ruajtur e përcjellë ato brez pas brezi.

# DASH-i: DIALOGU STRATEGJIK ME KOSOVËN, KUR TË PËRMBUSHEN KUSHTET DHE ZOTIMET NDAJ SERBËVE

Prishtinë, 17 korrik - Shtetet e Bashkuara thanë se janë në pritje të krijimit të kushteve për nisjen e Dialogut Strategjik me Kosovën, duke theksuar se ato përfshijnë edhe përmbushjen e zotimeve të Prishtinës ndaj pakicës serbe.
Në një përgjigje për Radion Evropa e Lirë, një zëdhënës i Departamentit Amerikan të Shtetit rikujtoi se Dialogu Strategjik u pezullua në shtator të vitit 2025, "për një periudhë të pacaktuar", për shkak të shqetësimeve lidhur me veprimet e Qeverisë në detyrë të Kosovës. "Ne mbetemi të përkushtuar për avancimin e interesave të përbashkëta të Shteteve të Bashkuara dhe popullit të Kosovës. Presim me padurim të zhvillojmë një Dialog Strategjik me Kosovën kur të krijohen kushtet e duhura, përfshirë përmbushjen nga Kosova të zotimeve të saj në raport me serbët e Kosovës", thuhet në përgjigje.
Departamenti i Shtetit nuk dha një afat se kur mund të nisë Dialogu Strategjik dhe nuk i specifikoi më shumë hapat që i pret nga autoritetet e Kosovës.
Përgjigjja vjen në ditën kur Uashingtoni nis raundin e parë të Dialogut Strategjik me Serbinë - një proces që synon thellimin e bashkëpunimit dypalësh në fusha si: siguria, ekonomia dhe politika e jashtme. "Nëpërmjet këtij dialogu, ShBA-ja dhe Serbia do të punojnë për arritjen e objektivave të përbashkëta, përfshirë paqen dhe stabilitetin rajonal, zgjerimin e lidhjeve në fushën e biznesit dhe arsimit, si dhe ndërtimin e një të ardhmeje më të begatë", tha zëdhënësi i Departamentit të Shtetit për Radion Evropa e Lirë.

### Kur dhe pse u pezullua Dialogu Strategjik me Kosovën?

Ambasada Amerikane në Prishtinë njoftoi më 12 shtator 2025 se Shtetet e Bashkuara e kishin pezulluar për një periudhë të pacaktuar Dialogun Strategjik me Kosovën. Në atë kohë, Ambasada tha se vendimi është marrë për shkak të "shqetësimeve lidhur me veprimet e qeverisë në detyrë", të cilat, sipas saj, "kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë" dhe kanë kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive me Kosovën për prioritetet e përbashkëta.
Vendimi erdhi pasi autoritetet e Kosovës ndërmorën veprime ndaj institucioneve serbe që funksiononin në Kosovë. Ato, po ashtu, kritikuan publikisht Gjykatën Kushtetuese të vendit për një vendim lidhur me mandatin e deputetëve.
Uashingtoni i cilësoi këto zhvillime si faktorë që rritën tensionet politike dhe vështirësuan bashkëpunimin, ndërsa qeveria në detyrë tha se ato ishin "të ligjshme dhe kushtetuese".




### Çfarë pritet nga Kosova në raport me serbët?

Prej vitesh, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian i kërkojnë Kosovës t'i zbatojë marrëveshjet e arritura në dialogun me Serbinë, të ndërmjetësuar nga BE-ja. Ato përfshijnë, mbi të gjitha, themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe sigurimin e një niveli të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, në përputhje me Marrëveshjen Bazë të vitit 2023 dhe Aneksin e Ohrit.
Po ashtu, Perëndimi kërkon që Kosova t'i zgjidhë kontestet me Kishën Ortodokse Serbe, të mbrojë liritë fetare dhe të shmangë veprime të njëanshme në veriun e vendit, të cilat, sipas Uashingtonit, kanë rritur tensionet me komunitetin serb.
Kosova argumenton se zbatimi i obligimeve nga dialogu duhet të jetë i ndërsjellë, ndërsa veprimet e saj në veri - nga heqja e dinarit serb nga përdorimi deri te mbyllja e shumicës së institucioneve paralele serbe - kanë pasur për qëllim shtrirjen e sundimit të ligjit.
Prishtina, gjithashtu, kërkon ta nënshkruajë Marrëveshjen Bazë, gjë të cilën Beogradi e ka refuzuar.
Për vazhdimin e dialogut me Serbinë, autoritetet e Kosovës kërkojnë ekstradimin e ish-nënkryetarit të Listës Serbe, Millan Radoiçiq, i cili ka marrë përgjegjësinë për sulmin e armatosur në Banjskë në shtator të vitit 2023.
Radoiçiq është nën sanksione të Shteteve të Bashkuara për përfshirje në korrupsion dhe aktivitete të krimit të organizuar, ndërsa ndaj tij është ngritur aktakuzë në Kosovë për terrorizëm dhe vepra të tjera penale.

## Kosova aplikon për lirimin e fondeve evropiane, Zulfaj: Pa bllokada do t'i prinim rajonit

Prishtinë, 17 korrik - Kosova ka dorëzuar kërkesën e parë zyrtare për lirimin e fondeve në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje të Bashkimit Evropian, duke përfshirë reformat e përfunduara deri më 30 qershor. Lajmin e ka bërë me dije kryenegociatori i Kosovës me BE-në dhe Koordinatori Kombëtar për Instrumentin për Reforma dhe Rritje, Jeton Zulfaj, i cili tha se kërkesa është dorëzuar brenda afatit zyrtar.
Sipas tij, në kërkesë janë përfshirë të gjitha reformat e realizuara që ishin paraparë në Agjendën e Reformave, përfshirë edhe ato që janë



përfunduar para afatit.
Zulfaj bëri me dije se Bashkimi Evropian do të ketë tre muaj kohë për t'i vlerësuar dëshmitë e dorëzuara nga Kosova, pas së cilës do të merret vendimi për lirimin e fondeve. Megjithatë, ai tha se në këtë kërkesë nuk janë përfshirë gjashtë hapa reformues që nuk janë përfunduar deri në afat për shkak të mosfunksionimit të Kuvendit. "Pesë prej tyre përmbanin ligje që duhej të kalonin në Kuvend, ndërsa një ishte hap që nuk mund ta aprovonte Qeveria në detyrë", ka deklaruar Zulfaj.
Ai ka vlerësuar se bllokada në Kuvend ka ndikuar negativisht jo vetëm në ritmin e reformave, por edhe në fondet e Bashkimit Evropian të dedikuara për zhvillimin dhe integrimin e Kosovës. "Nëse Kuvendi do të ishte funksional, të gjithë hapat do të arriheshin në kohë. Nëse nuk do ta kishim bllokadën në Kuvend, Kosova do t'i printe rajonit për përmbushjen e reformave", ka shkruar Zulfaj.
Ai bëri me dije se hapat reformues të papërfunduar do t'i përcillen legjislaturës së re pas konstituimit të saj.
Kërkesa e radhës për lirimin e fondeve nga Kosova, sipas Zulfajt, pritet të dorëzohet më 15 janar 2027, ndërsa deri në fund të këtij viti institucionet duhet të përmbushin dhjetëra hapa të tjerë reformues.
Instrumenti për Reforma dhe Rritje i BE-së synon t'i mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor përmes financimit të reformave që lidhen me zhvillimin ekonomik dhe procesin e integrimit evropian.

# MINISTRIA E BUJQËSISË THOTË SE RAPORTI FINAL I ANALIZAVE TË QUMËSHTIT VITA DO TË DALË MË 27 KORRIK



**Prishtinë, 17 korrik** - Përplasja mes Qumështores "Vita" dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me publikimin e rezultateve të analizave të mostrave të qumështit ka vazhduar edhe pas reagimeve të fundit nga të dyja palët. "Vita" ka kërkuar publikimin e menjëhershëm të rezultateve të analizave, duke thënë se afati për publikimin e tyre ka kaluar.

Në një deklaratë për medie, kompania ka rikujtuar se më 6 korrik kishte njoftuar se do të rifillonte grumbullimin e qumështit nga fermerët, pas një takimi ku, sipas saj, ministri dhe përfaqësuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) kishin premtuar publikimin e rezultateve jo më larg më se 13 korrik. "Pavarësisht shumë emailave dhe kërkesave zyrtare të drejtuara Ministrisë dhe AUV, rezultatet e analizave të mostrave po mbahen në AUV dhe nuk po publikohen nga Ministria apo AUV", thuhet në reagimin e Vita-s.

Kompania ka shprehur paqartësi për arsyet e vonesës, duke kërkuar që rezultatet e mostrave të marra më 2 korrik të bëhen publike. "Ne si Qumështore Vita nuk e kemi të qartë se për çfarë arsye AUV nuk është në gjendje që të na përcjellë rezultatet e analizave të marra më datë 02.07.2026. Pra, kanë kaluar më shumë se 2 javë nga data e marrjes së mostrave", thuhet në deklaratë.

"Vita" ka deklaruar se është e bindur për cilësinë e produktit të saj.

Kompania ka bërë thirrje që rezultatet të publikohen sa më shpejt, duke thënë se kjo do t'u japë fund dyshimeve të ngritura në opinion. "Fermerët nuk meritojnë heshtje. Qytetarët nuk meritojnë paqartësi. Kosova meriton institucione që mbajnë fjalën e dhënë!", ka deklaruar "Vita".

Ndërkohë, Ministria e Bujqësisë ka reaguar duke mohuar se ka dhënë ndonjë zotim zyrtar për publikimin e rezultateve më 13 korrik. "Ministria nuk ka bërë asnjë zotim publik apo zyrtar se rezultatet e analizave do të publikoheshin më 13 korrik 2026. Për këtë arsye, pretendimi se është shkelur një afat i premtuar nuk qëndron", ka thënë ministria.

Sipas Ministrisë, rezultatet laboratorike janë vetëm një pjesë e procedurës së kontrollit zyrtar dhe para publikimit duhet të përfundojnë edhe verifikimet administrative, teknike dhe ligjore. "Publikimi i rezultateve të pjesshme ose i analizave të veçuara para përfundimit të procedurës zyrtare do të ishte në kundërshtim me parimet e kontrollit zyrtar dhe do të mund të çonte në keqinterpretim të gjetjeve", thuhet në reagim.

Ministria ka bërë me dije se kryeshefi ekzekutiv i AUV-së ka konfirmuar se raporti përfundimtar do të dorëzohet jo më vonë se më 27 korrik 2026, ndërsa nëse procedurat përfundojnë më herët, raporti do të publikohet para këtij afati.

Në fund, Ministria thekson se nuk do t'i komentojë pretendimet e operatorëve ekonomikë derisa procedura zyrtare të përfundojë. "Interesi ynë i vetëm është mbrojtja e shëndetit të konsumatorit, trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë dhe garantimi i integritetit të procesit të kontrollit zyrtar. Menjëherë pas përfundimit të procedurës, rezultatet dhe gjetjet përfundimtare do t'i bëhen publike në mënyrë transparente", përfundon njoftimi.

# DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRISË E KOSOVËS DISKUTON ME DOGANËN PËR SFIDAT E BIZNESEVE

**Prishtinë, 17 korrik** - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës, së bashku me bizneset anëtare, organizoi një bashkëbisedim me drejtorin gjeneral të Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, rreth sfidave me të cilat përballen bizneset dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Kryetari i Bordit, Skender Krasniqi, tha se bizneset presin që sa më shpejt të konstituohen institucionet, në mënyrë që të adresohen çështjet që, sipas tij, po i pengojnë prodhuesit vendorë. Ai theksoi se një nga kërkesat kryesore të Dhomës së Tregtisë, e përsëritur tash e dhjetë vjet, është çështja e TVSh-së, e cila, sipas tij, është një sfidë për bizneset. "Urojmë që sa më shpejt t'i kemi institucionet, Kuvendin dhe Qeverinë, në mënyrë që t'i adresojmë të gjitha këto çështje. Si Dhomë e Tregtisë, tash e 10 vjet kemi kërkuar që TVSh-ja të paguhet me inkasim e jo me faturim. Kjo është pengesa që po na krijohet neve, sidomos kur po flasim për prodhuesit. Ka shumë çështje që duhet të adresohen dhe ku duhet të ndërhyhet me urgjencë për t'i ndryshuar", tha Krasniqi.



Ndërkaq drejtori gjeneral i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, shpalosi angazhimet e institucionit që drejton dhe gatishmërinë për vazhdim të komunikimit dhe bashkëpunimit me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë.

Drejtori Llugaliu përmendi masat e ndërmarra për lehtësimin e tregtisë me Shqipërinë, ku është duke u punuar për krijimin e një zyre të përbashkët doganore me Shqipërinë, e cila, sipas tij, do ta lehtësojë dhe përshpejtojë procesin e eksporteve mes dy vendeve. Ai theksoi se kjo do të mundësojë zgjidhjen më të shpejtë të problemeve në rritjen e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Në takim bizneset adresuan sfidat me të cilat po përballen, duke nisur nga procedurat doganore, lehtësimi i tregtisë dhe sfidat me të cilat përballen në aktivitetin e tyre të përditshëm. Po ashtu, bizneset shprehen shqetësimet e tyre për disa mallra të importuara për lëndën e parë të prodhimit që kanë akcizë të lartë.

Drejtori i Doganës premtoi adresimin e të gjitha problematikave në mënyrën e duhur në bazë të legjislacionit në fuqi dhe në afat sa më të shpejtë.

# KUSARI-LILA PRITI DELEGACION AMERIKAN, DISKUTOJNË PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK KOSOVË - SHBA

Prishtinë, 17 korrik - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, së bashku me zëvendësministrin e Mbrojtjes, Gegë Lleshi, mirëpriti në Kosovë një delegacion nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilin diskutoi për thellimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së.



Delegacioni përbëhej nga Dustin Edward Plantholt, Fadi Elsalameen, William McClure, Doru Borșan, Riad Bouaziz dhe Lisa Corsa, të cilët sjellin përvojë të gjerë profesionale në fushën e teknologjisë, inovacionit, transformimit digjital, biznesit, administratës publike, qeverisjes lokale, sigurimeve, turizmit, shëndetësisë, si dhe politikës së jashtme dhe çështjeve strategjike.

Gjatë takimit u vlerësua se shkëmbimi i përvojave dhe ekspertizës ndërmjet këtij delegacioni, institucioneve dhe bizneseve në Kosovë mund të krijojë mundësi të reja për zhvillim ekonomik, partneritete dhe tërheqjen e investimeve amerikane në këta sektorë si dhe në fusha të tjera me potencial për vendin.

Me këtë rast, ministrja Kusari-Lila shprehu mirënjohjen institucionale dhe të qytetarëve të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara në rrugëtimin e Kosovës drejt shtetndërtimit dhe zhvillimit demokratik. Ajo theksoi se partneriteti ndërmjet dy vendeve po merr gjithnjë e më shumë një dimension ekonomik, me fokus në investime, inovacion dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Ministrja paraqiti gjithashtu prioritetet e qeverisë për transformimin e ekonomisë së vendit, përmes rritjes së prodhimit vendor, fuqizimit të eksporteve të produkteve "Made in Kosova", zhvillimit të parqeve industriale dhe teknologjike, mbështetjes së sektorit privat dhe krijimit të një mjedisi edhe më të favorshëm për investitorët e huaj.

# PROMOVOHET LIBRI “BASHKËBISEDIM ME FADIL VATËN (1989)”, QË DOKUMENTON NJË PERIUDHË KYÇE TË HISTORISË SË KOSOVËS




PRISHTINË, 17 KORRIK - Në prani të shumë personaliteteve publike, akademike e kulturore, bashkëveprimtarëve dhe familjarëve, të premten në Institutin Albanologjik në Prishtinë është promovuar libri “Bashkëbisedim me Fadil Vatën (1989)” i autorit Hajdin Abazi. Vepra, e ndarë në 12 kapituj dhe me 355 faqe, i kushtohet figurës së veprimtarit Fadil Vata dhe zhvillimeve politike që paraprinë periudhën vendimtare të vitit 1989.

Përmes bashkëbisedimeve, libri sjell kujtime, analiza dhe dëshmi mbi rrethanat politike të asaj kohe, duke u fokusuar në rolin e Fadil Vatës dhe bashkëveprimtarëve të tij.

Autori Hajdin Abazi tha se vendimi për ta shkruar librin erdhi pas një dileme të gjatë personale, por se ndjeu obligim moral për t'i dokumentuar bisedat që kishte zhvilluar me Fadil Vatën dhe Afrim Zhitinë. “Ka disa vite, ndoshta dy dekada, që kam zhvilluar një luftë me veten nëse duhej t’u hyja shkrimeve të këtyre kujtimeve apo jo. Nuk kisha siguri në vetvete nëse do t’ia dilja, por ajo që më nxiste ishte fakti se isha i vetmi që pata fatin të isha me ta dhe të bisedoja për ato ndryshime të mëdha. Prandaj, ndjeva se kisha një borxh moral. Asnjëherë, askund në libër, nuk e kam mohuar pikëpamjen tonë ideologjike. Bisedat kanë qenë kryesisht me Fadil Vatën dhe Afrim Zhitinë. Shpesh dëgjoj të thuhet se ata ishin udhëheqës të Kosovës, por jo, ata ishin udhëheqës të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Kërkesat ishin të mëdha dhe në libër disa gjëra i kam lënë me tri pika, sepse nuk kam mundur t’i përfshij të gjitha”, tha Abazi.



Ish-ministri i Jashtëm, profesori dhe deputeti Enver Hoxhaj, vlerësoi se emri i Fadil Vatës është i lidhur ngushtë me fundin e një epoke dhe fillimin e një tjetre për shqiptarët në Kosovë, duke e cilësuar atë si një nga ideologët dhe vizionarët më të rëndësishëm të kohës. “Me emrin e Fadil Vatës, por edhe me gjeneratën e tij dhe Afrim Zhitinë, lidhet padyshim fundi i një historie dhe fillimi i një tjetre. Fundi i pushtimit dhe i shpërbërjes së Jugosllavisë, por edhe fillimi i lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Ai ka qenë ndër ideologët, vizionarët dhe veprimtarët më të mëdhenj që ka pasur Kosova dhe trojet shqiptare. Ideali i tij politik, përgatitja intelektuale dhe guximi e bëjnë Fadilin shembull frymëzimi jo vetëm për gjeneratën e tij, por edhe për gjeneratat që do të jetojnë në Kosovë”, tha Hoxhaj.

Ai përgëzoi autorin Hajdin Abazi për librin dhe mënyrën e ndërtimit të tij, duke e cilësuar si një formë moderne të paraqitjes së mendimit politik. “Unë dua ta përgëzoj autorin e librit, Hajdin Abazin, për një libër të shkëlqyeshëm që ka shkruar dhe një formë moderne e shkrimit të librit, ku autori është në bashkëbisedim me ideologun e madh, Fadil Vatën. Si i tillë, libri është njëra prej formave më perëndimore të paraqitjes së ideve politike, të diskursit politik, të idealit politik të një kohe të caktuar”, tha Hoxhaj.




Ndërkaq, bashkëveprimtari i afërt i Fadil Vatës, Ibrahim Shala, tha se libri paraqet një qasje të veçantë, pasi rrëfimi ndërtohet përmes bashkëbisedimeve të personazheve kryesore dhe përqendrohet në muajt janar dhe shkurt të vitit 1989.

“Është një libër që thyen paragjykimet dhe ideologjinë dogmatike. Një vepër shumë e veçantë, me një qasje të realizuar përmes bashkëbisedimeve të personazheve kryesore, gjë që shprehet edhe në titullin e librit. Harku kohor është i përqendruar vetëm në muajt janar dhe shkurt të vitit 1989. Që në hyrje të librit, autori na bën me dije se ai është rezultat i bashkëbisedimeve politike në një periudhë dinamike, të tensionuar dhe dramatike për Kosovën”, tha ai.

Edhe bashkëveprimtari tjetër i Fadil Vatës, Ramadan Avdiu, tha se libri “Bisedë me Fadil Vatën” është një dokument historik dhe dëshmi autentike që sjell para lexuesit botën intelektuale, politike dhe njerëzore të Fadil Vatës. “Duke e lexuar bashkëbisedimin, gjegjësisht veprën ‘Bisedë me Fadilin’ të autorit Hajdin Abazi, krijova përshtypjen sikurse edhe unë u ndodha në atë shtëpinë e vogël buzë qytezës së Obiliqit, në shtëpinë e veprimtarit Sadik Makolli e Sefedie Makolli, që është motra e veprimtarëve të mirënjohur Sahit Krasniqi e Avni Krasniqi, të cilën po shoh që e kemi këtu. Edhe m’u duk, m’u krijua përshtypja sikur edhe unë u ndodha aty. Besoj që kur ta lexojnë bashkëveprimtarët, edhe ata do ta kenë një ndjesi të tillë”, tha ai.

Ai tha se promovimi i kësaj vepre është rikthim i kujtesës për një periudhë të rëndësishme të historisë së Lëvizjes Kombëtare. “Sot nuk po promovojmë thjesht një libër. Sot po rikthejmë kujtesën tonë të një pjese të rëndësishme të historisë së Lëvizjes Kombëtare. Një histori që u shkrua me sakrifica, me burgje, me organizime në fshehtësi, me përpjekje, vendosmëri, por edhe me besim të palëkundur se populli shqiptar duhet të jetojë i lirë në vendin e vet”, shtoi Avdiu.









Ky libër hedh dritë mbi jetën, veprimtarinë politike dhe angazhimin kombëtar të njërit prej figurave më të njohura të lëvizjes ilegale shqiptare në Kosovë.

Libri sjell dëshmi, kujtime dhe rrëfime për Fadil Vatën, duke e paraqitur atë si një lider politik me formim filozofik dhe organizativ, i përfshirë në lëvizjet ilegale që nga fundi i viteve ’70.

Në këtë libër përshkruhen aktivitetet e Fadil Vatës në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), organizimi i protestave studentore dhe përkrahja për grevën e minatorëve të vitit 1989.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montim
Servisim
Porosi

# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Trepça, Bashkimi dhe Peja mësojnë kundërshtarët në FIBA Europe Cup



**Prishtinë, 17 korrik** - Klubet e Kosovës kanë mësuar kundërshtarët e tyre në edicionin 2026/27 të FIBA Europe Cup, pas shortit të hedhur të enjten në Munih, Gjermani.

Kampionia e Kosovës, Trepça, është shortuar në Grupin A, ku do të përballet me Promitheas Patras (Greqi), Opava (Çekia), VET-CONCEPT Gladiators Trier (Gjermani); Split (Kroaci), Batumi 2010 (Gjeorgji).

Bashkimi do të garojë në Grupin F, ku do të përballet Bigbank/Kalev (Estoni); Glint Manisa Basket (Turqi), Elan Chalon (Francë), Valmiera Glass VIA (Letoni) dhe Manchester Basketball (Britania e Madhe).

Ndërkohë, Peja do ta nisë rrugëtimin evropian nga raundi kualifikues, ku do të përballet me Dinamo Bukureshtim (Rumani). Ndeshjet do të zhvillohen me sistem vajtje-ardhje, ndërsa fituesi do të sigurojë një vend në fazën e grupeve të FIBA Europe Cup.

Ndeshjet kualifikuese janë planifikuar për 23 dhe 30 shtator, ndërsa faza e grupeve e FIBA Europe Cup 2026/27 do të nisë më 7 tetor.

## FANELLA E PELES NË FINALEN E KUPËS SË BOTËS 1958 SHITET 4.9 MILIONË DOLLARË

**Prishtinë, 17 korrik** - Një fanellë e veshur nga legjenda braziliane, Pele, gjatë finales së Kupës së Botës 1958 është shitur për 4.9 milionë dollarë (4.28 milionë euro) në një ankand të Sotheby's në Nju-Jork.

Është fanella e dytë më e vlefshme e futbollit e shitur, pas fanellës së Argjentinës që Diego Maradona veshi kur shënoi golin e njohur si "Dora e Zotit" kundër Anglisë në Kupën e Botës 1986 - e cila u shit për 7.1 milionë funte (8.36 milionë euro) në vitin 2022.

Duke marrë gjithsej 10 oferta nga më shumë se pesë ofertues, fanella e Peles nga finalja e vitit 1958 është sendi i tij më i vlefshëm i relikteve i shitur ndonjëherë në ankand. Pikërisht kjo fanellë u shit në vitin 2004 për vetëm 105 600 dollarë (92, 308 euro).

Pele shënoi dy herë kundër Suedisë si 17-vjeçar në finalen e Kupës së Botës 1958, duke fituar trofeun e parë nga tri Kupat e Botës së tij. Ai ende mban rekordin për lojtarin më të ri që shënon në një finale të Kupës së Botës.




"Rezultati i sotëm është një dëshmi e fuqishme e trashëgimisë së qëndrueshme të njërit prej futbollistëve më të mëdhenj të të gjitha kohëve", tha Brendan Hawkes, kreu i strategjisë dhe zhvillimit sportiv në Sotheby's. "Kjo fanellë nuk është vetëm një kujtesë e përhershme e njërit prej momenteve më të rëndësishme në historinë e futbollit, por është kryesisht e lidhur me momentin që e katapultoi Pelen në një ikonë globale të sportit", shtoi ai.

Artikuj të tjerë të shitur në ankandin 'The Beautiful Game' të enjten përfshinin shiritin e kapitenit që mbante Maradona gjatë Kupës së Botës 1986 - përfshirë edhe kur shënoi golin 'Dora e Zotit' kundër Anglisë - i cili u shit për 512 000 dollarë (447 554 euro).

Një fanellë e veshur nga Lionel Messi gjatë fitores dramatike 6-1 të Barcelonës kundër Paris St-Germain në 1/8-n e finales së Ligës së Kampionëve në vitin 2017 u shit për 217 600 dollarë (190 210 euro), ndërsa fanella e David Beckham nga paraqitja e tij e 50 me Anglinë në Kupën e Botës 2002 u shit për 51 200 dollarë (44 755 euro).

## GJASHTË YJET E ARGJENTINËS RREZIKOJNË PEZULLIMIN NGA FIFA PËR FINALEN E BOTËRORIT

**Prishtinë, 17 korrik** - FIFA është vënë nën presion që të ndërmarrë masa të ashpra ndaj deri në gjashtë futbollistëve të Argjentinës përpara finales së Kupës së Botës 2026 kundër Spanjës.

Skuadra e drejtuar nga Lionel Scaloni siguroi kualifikimin në finalen e madhe pas fitores me përmbysje 2-1 ndaj Anglisë falë golave të Enzo Fernandez dhe Lautaro Martinez. Megjithatë, polemikat nuk u kufizuan vetëm në fushën e lojës.

Para ndeshjes së zhvilluar në stadiumin e Atlantës, disa futbollistë argjentinas u filmuan duke kënduar këngë që lidhen me Ishujt Falkland (Malvinas), territor për të cilin Argjentina dhe Britania e Madhe zhvilluan luftë në vitin 1982.

Pas eliminimit të Anglisë, polemikat u shtuan edhe më shumë, pasi disa lojtarë të Argjentinës u panë duke mbajtur një pankartë me mbishkrimin "Las Malvinas son Argentinas" ("Malvinat janë argjentinase").

Sipas rregulloreve të FIFA-s, deklaratat dhe mesazhet politike janë të ndaluara në aktivitetet zyrtare të futbollit, çka ka bërë që shumë persona të kërkojnë ndëshkimin e lojtarëve argjentinas.

Mes zërave më të fortë është ai i politikanit britanik Ed Davey, lider i Partisë Liberal Demokrate, i cili i ka bërë thirrje FIFA-s të pezullojë gjashtë futbollistë të Argjentinës për finalen ndaj Spanjës. Ai e krahasoi rastin me atë të vitit 2024, kur UEFA pezulloi për një ndeshje Rodrin dhe Alvaro Moratën pasi kënduan sloganin "Gibraltari është Spanjë" gjatë festimeve. "Në gusht të vitit 2024, Rodri dhe Alvaro Morata u pezulluan me të drejtë për një ndeshje pasi kënduan 'Gibraltari është Spanjë'. Tani edhe lojtarët argjentinas që festuan me pankartën 'Falklandet janë argjentinase' duhet të ndalohen të luajnë në finale", deklaroi Davey.




Në një intervistë për "Sky News", politikani britanik zbuloi se i ka dërguar një letër presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino. "Këto janë rregullat që ai duhet t'i zbatojë dhe të sigurojë që respektohen. Ajo që bënë lojtarët argjentinas ishte një deklaratë e qartë politike dhe një shkelje e rregulloreve të FIFA-s. Është gjithashtu fyese për banorët e Ishujve Falkland dhe familjet e veteranëve që humbën jetën gjatë pushtimit të paligjshëm", u shpreh ai.

### Shkëndija kalon në raundin e dytë të Ligës së Konferencës me fitore edhe në ndeshjen e kthimit

**Prishtinë, 17 korrik** - Shkëndija ka siguruar kualifikimin në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës, duke mposhtur edhe në ndeshjen e kthimit kundërshtarin nga Gjibraltari me rezultat minimal 1-0.




Skuadra tetovare e kishte kryer praktikisht punën që në takimin e parë, kur kishte triumfuar bindshëm 5-0 në transfertë, ndaj sfida e zhvilluar në Arenën Kombëtare ishte më shumë një formalitet.

Ndeshja nuk solli shumë emocione, pasi të dyja ekipet e kishin të qartë se çështja e kualifikimit ishte pothuajse e mbyllur. Megjithatë, Shkëndija ishte skuadra më kërkuese dhe krijoi rastet më të mira.

Me këtë sukses, Shkëndija e mbylli me dy fitore përballjen e raundit të parë kualifikues dhe siguroi kalimin në fazën tjetër.

Në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës, skuadra nga Tetova do të përballet me ekipin slloven, Bravo.

## Ballkani avancon në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Konferencës



**Prishtinë, 17 korrik** - FC Ballkani ka siguruar kualifikimin në raundin e dytë kualifikues të UEFA Conference League, duke eliminuar skuadrën uellsiane Connah's Quay Nomads.

Në ndeshjen e kthimit, të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, Ballkani triumfoi me rezultat 3:2, duke vulosur avancimin pas barazimit 0:0 në takimin e parë të zhvilluar në Uells.

Ballkani krijoi epërsi të rehatshme prej 3:0 falë golave të Edvin Kuçit, Giovanni Ribeiros dhe Valentin Serebes. Megjithatë, mysafirët reaguan në pjesën e fundit të ndeshjes dhe ngushtuan rezultatin me golat e Max Woodcock nga penalltia dhe Hussein Mehasseb, duke e bërë përfundimin më dramatik. Pavarësisht presionit në minutat e fundit, skuadra nga Suhareka ruajti epërsinë dhe siguroi kalimin në fazën e ardhshme.

Në raundin e dytë kualifikues Ballkani do të përballet me skuadrën irlandeze Bohemians, me synimin për ta vazhduar rrugëtimin evropian.

F2.3/BNJ-KP/PT

Kompania Rajonale e Mbeturinave Regionalna Kompanija za Uklanjanje Otpada "PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/5331
Dt. 17.07.2026
Shtojcë
Prishtinë-Pristina

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A**

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 17/07/2026 me numër të protokollit 02/01/413 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

**KONKURS PUBLIK**
**Për plotësimin e vendit të punës**

| | |
|---|---|
| Titulli i Vendit të punës: | Punëtor i Bartjes |
| Nr. i kërkuar: | Njëzet e tre pozita (23), NJO Prishtinë në KRM "Pastrimi" SH.A |
| Numri i Referencës: | **KP/PT**/NJOP/15-2026 |
| Koeficienti/Paga mujore: | Niveli XII |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar |
| Periudha Provuese: | 3 muaj |

1. **Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1.1 Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
1.2 Bënë zbrazjen e kontejnerëve në automjet/kamion;
1.3 Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
1.4 Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bënë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
1.5 Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hudhjen e kripës;
1.6 Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre ne kontejnerin përkatës;
1.7 Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
1.8 Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët ti vendosë në vendin paraprak;
1.9 Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
1.10 Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
1.11 Për punën e tij i raporton Udhëheqësit të Njësisë së Bartjes në Prishtinë.

**2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:**
- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një vepërs penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

**3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit**
- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

**4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

| | |
|---|---|
| Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati | ✓ |
| Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme) | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës) | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme) | ✓ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme) | ✓ |
| Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës | ✓ |
| Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj | ✓ |

**4.2 Forma e Konkursit Publik pa test (KP/PT):**
-Konkursi për këtë pozitë zhvillohet me procedurë të veçantë, pa testim me shkrim dhe përfshin vetëm vlerësimin e CV-së dhe intervistën profesionale.

**5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**
**5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**
* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**5.2 Dorëzimi i aplikacionit:**
* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;**
Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 18/07/2026 deri me datën 01/08/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

**5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**
**5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**
* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**5.2 Dorëzimi i aplikacionit:**
* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;**
Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 18/07/2026 deri me datën 01/08/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

**7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.**
Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:
- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

**8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**
Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

**9. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**
Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

**Vërejtje**: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

**Njoftim për shuarje biznesi nga "MM FB 02" Sh.p.k**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "MM FB 02" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812407460 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "MM FB 02" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812407460 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "MM FB 02" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812407460 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

F2/BNJ/KB/RR

Kompania Rajonale e Mbeturinave "PASTRIMI" SH.A. / d.d.
Nr. 06/03/1533/
Dt. 17.07.2026
Prishtinë-Priština

## REGIONALNA KOMPANIJA ZA OTPAD „PASTRIMI“ A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, konkretno člana 8, na osnovu Pravilnika br. 07/2024 o radnom odnosu u RKO „Pastrimi“ A.D., konkretno člana 11, stav 1.2 i člana 12, na osnovu Pravilnika br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RKO „Pastrimi“ A.D., na osnovu Odluke Upravnog odbora sa br. protokola 01/14/37 od 02.09.2025. godine, na osnovu Odluke Izvršnog odbora sa br. protokola 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke Izvršnog odbora o test pozicijama sa br. protokola 7096 od 15.11.2024. godine, i na osnovu Odluke od 17.07.2026. godine sa brojem protokola 02/01/413 Glavnog izvršnog oficira RKO „Pastrimi“ A.D., raspisuje se sledeći:

### JAVNI KONKURS
**Za popunjavanje radnog mesta**

| | |
|---|---|
| **Naziv radnog mesta:** | Radnik na nanošenju/utovaru otpada (Radnik na boci) |
| **Broj izvršilaca:** | Dvadeset tri pozicije (23), Operativna jedinica Priština u RKO „Pastrimi“ A.D. |
| **Referentni broj:** | KP/PT/NJOP/15-2026 |
| **Koeficijent / Mesečna plata:** | Nivo XII |
| **Trajanje ugovora o radu:** | Na neodređeno vreme |
| **Probni rad:** | 3 meseca |

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Vrši sakupljanje otpada u određenim zonama;
- Vrši pražnjenje kontejnera u vozilo/kamion;
- Vrši čišćenje zone oko kontejnera;
- Na osnovu operativnog plana i radnog naloga vrši čišćenje i pranje ulica i trotoara (stav 1.4);
- Vrši čišćenje trotoara i ulica od snega i bacanje soli;
- Vrši uklanjanje uginulih životinja sa puta i njihovo postavljanje u odgovarajući kontejner;
- Odgovoran je za učtivo ponašanje prema građanima i korisnicima usluga kompanije;
- Odgovoran je da nakon sakupljanja otpada, kontejnere vrati na prethodno mesto;
- Stara se i odgovoran je za pažljivu upotrebu radnih sredstava i kontejnera;
- Obavlja i druge poslove kojima ga angažuje rukovodilac;
- Za svoj rad izveštava Rukovodiocu jedinice za prevoz u Prištini.

**2. Opšti kriterijumi za prijem na dužnost:**

- Da je državljanin Republike Kosovo;
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o upotrebi jezika;
- Da je sposoban/na za obavljanje odgovarajuće dužnosti;
- Da nije osuđivan/na za krivično delo;
- Da nema na snazi disciplinsku meru za težu povredu radne dužnosti u javnoj instituciji;
- Da poseduje veštine potrebne za ovu poziciju;
- Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene zakonom.

**3. Znanja, veštine i osobine koje se zahtevaju u postupku regrutacije:**

- Pažljivost i obraćanje pažnje na detalje;
- Sposobnost za samostalan rad;
- Veštine pružanja usluga klijentima;
- Poznavanje javne bezbednosti;
- Sposobnost za dobar manuelni rad (rad rukama);
- Fizička sprema i izdržljivost;
- Sposobnost organizovanja vremena i obima posla;
- Dobre veštine verbalne komunikacije.

**4. Dokumenta koja se podnose u sklopu prijave i način njihovog podnošenja:**

| Potrebna dokumentacija | Podnosi se |
|---|---|
| Prijava za zapošljavanje i CV, popunjeni i potpisani od strane kandidata | ✔ |
| Dokaz o školskoj kvalifikaciji izdat od strane obrazovnih institucija (poželjno) | ✔ |
| Kopija dokaza o radnom iskustvu (Penzioni trust, potvrda ili ugovor o radu) | ✔ |
| Kopija dokaza o obukama i kursevima (poželjno) | ✔ |
| Kopije ocena rada za poslednje dve godine (poželjno) | ✔ |
| Identifikacioni dokument Republike Kosovo | ✔ |
| Potvrda od suda da osoba nije pod istragom, NE starija od 6 meseci | ✔ |

**4.2 Forma javnog konkursa bez testa (KP/PT):**
*Konkurs za ovu poziciju sprovodi se po posebnom postupku, bez pismenog testiranja, i obuhvata samo procenu CV-ja i profesionalni intervju.*

**5. Način prijavljivanja na konkurs i podnošenje prijave:**
**5.1 Preuzimanje zvaničnih obrazaca vrši se:**

- Preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave „Pastrimi“ Sh.A.
- Na recepciji kompanije.

**5.2 Podnošenje prijave:**

- Prijava za zapošljavanje sa kompletnom dokumentacijom podnosi se isključivo elektronskim putem na adresu: punesimi.krmpastrimi@gmail.com u PDF formatu.
- U slučaju internih i eksternih konkursa za tehničke pozicije, prijava se može podneti i u fizičkom obliku preko arhive kompanije.

**6. Tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa:**
Konkurs Publik traje 15 dana od data 18.07.2026. do dana 01.08.2026. godine.
Krajnji rok za prijem prijava je do 16:00 časova.
Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se uzeti u razmatranje.

**7. Način procene i kriterijumi bodovanja:**
Postupak procene sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prag prolaznosti postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova u svim fazama javnog konkursa.
Procena kandidata vrši se na osnovu:

- CV-ja kandidata: do 25 bodova
- Intervjua: do 75 bodova.

**8. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima:**
Svi kandidati će biti obavešteni elektronskim putem i pojedinačno.

**9. Okvirni kalendar postupka regrutacije:**

- Faza preliminarne provere prijava: do 7 dana;
- Faza pismenog testa: do 10 dana nakon faze provere (važi za pozicije koje predviđaju test);
- Faza intervjua: do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;
- Objavljivanje rezultata: vrši se do 3 dana nakon procene intervjua.

**Napomena:** *Nepotpuna, neskenirana dokumentacija, kao i ona koja stigne nakon isteka roka konkursa, neće biti razmatrana.*

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fis Rogova nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Shani Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10,11,12,13 dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Dion Macula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11 të gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

Saranda Karakushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1,2,3,4 dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë në Gjakovë.

- Bajram Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën nga kl, 6-9 të sh.m.u. “Rudolf Walther” Dejnë kk Gjakovë.

- Leart Vehapi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Adizo SH.P.K. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.

- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

F2.1/BNJ/KP/PT

Nr. 06/03/5332
Dt. 17.07.2026

## KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, bazuar në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh. A. konkretisht nenin 11, paragrafi 1.1 dhe neni 12, paragrafi 7, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokolli 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokolli 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitat test me nr. protokolli 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 17.07.2026 me numër të protokollit 02/01/412 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

### KONKURS PUBLIK
**Për plotësimin e vendit të punës**

Titulli i Vendit të punës: Punëtor i Higjienës Publike
Nr. i kërkuar: Trembëdhjetë (13) pozita, Njësia Operative Prishtinë në KRM "Pastrimi" SH.A
Numri i Referencës: **KP/PT**/NJOP/16-2026
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese: 3 muaj

**1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:**
- Kryen punët e përcaktuara në urdhëresën e punës nga udhëheqësi;
- Bënë pastrimin e rrugëve sipas urdhëresës në terrenin e përcaktuar në urdhëresë sipas planit Operativ;
- Përmbushë detyrat në atë mënyrë për të mos penguar komunikacionin apo lëvizjen e qytetarëve;
- Është përgjegjës për përdorimin e kujdesshëm të mjeteve të punës dhe raporton cdo problem lidhur me pamundësinë e kryerjes së punës;
- Kryen edhe punë të tjera që kërkohen nga udhëheqësi sipas nevojës;
- Për punën e tij i raporton Koordinatorit dhe Kryepunëtorit.

**2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:**
- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

**3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit**
- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

**4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

| | |
|---|---|
| Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati | ✔ |
| Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme) | ✔ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës) | ✔ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme) | ✔ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme) | ✔ |
| Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës | ✔ |
| Vërtetim nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj | ✔ |

**4.1 Forma e Konkursit Publik pa test (KP/PT):**
-Konkursi për këtë pozitë zhvillohet me procedurë të veçantë, pa testim me shkrim dhe përfshin vetëm vlerësimin e CV-së dhe intervistën profesionale.

**5. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:**
**5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:**
* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh. A.
* në recepcionin e kompanisë.

**5.2 Dorëzimi i aplikacionit:**
* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitat teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

**6. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:**
Konkursi zgjatë 15 ditë nga data 18/07/2026 deri me datën 01/08/2026.
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

**7. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.**
Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:
- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

**8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.**
Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

**9. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:**
Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

**Vërejtje**: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

F2.1/BNJ/KP/PT

Nr. 06/03/5332
Dt. 17.07.2026

## REGIONALNA KOMPANIJA ZA OTPAD „PASTRIMI "A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03/L-212, konkretno člana 8, na osnovu Pravilnika br. 07/2024 o radnom odnosu u RKO „Pastrimi "A.D., konkretno člana 11, stav 1.1 i člana 12, stav 7, na osnovu Pravilnika br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RKO „Pastrimi "A.D., na osnovu Odluke Upravnog odbora sa br. protokola 01/14/37 od 02.09.2025. godine, na osnovu Odluke Izvršnog odbora sa br. protokola 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke Izvršnog odbora o test pozicijama sa br. protokola 7096 od 15.11.2024. godine, i na osnovu Odluke od 17.07.2026. godine sa brojem protokola 02/01/412 Glavnog izvršnog oficira RKO „Pastrimi "A.D., raspisuje se sledeći:

### JAVNI KONKURS
**Za popunjavanje radnog mesta**

| | |
|---|---|
| **Naziv radnog mesta:** | Radnik na javnoj higijeni |
| **Broj izvršilaca:** | Trinaest (13) pozicija, Operativna jedinica Priština u RKO „Pastrimi "A.D. |
| **Referentni broj:** | KP/PT/NJOP/16-2026 |
| **Koeficijent / Mesečna plata:** | Nivo XII |
